

## G.3 PARAQITËSI

Shfaqja e regjistrimeve nga lista e rezultateve të kërkimit bëhet e mundur në dritaren **Paraqitja – CORES** dhe funksionon njësoj si në paraqitësin e regjistrimeve bibliografike, por ndryshojnë të dhënat në shfaqjen e regjistrimit dhe numri i formateve të shfaqjes. Për dallim nga paraqitësi i regjistrimeve bibliografike, ekzistojnë vetëm dy lloje të formatit të shfaqjes (pa formatin standard).

---

### G.3.1 Formati bazë

Formati bazë mundëson paraqitjen e regjistrimit në formën e listës së attributeve.

Në formatin bazë shfaqen këto attribute dhe vlerat e tyre, nëse ekzistojnë:

- ISSN
- titulli
- autori – person
- autori – organizatë
- CORES.XX-ID

Regjistrimet nga baza e të dhënave CORES janë të lidhura me regjistrimet nga COBIB-i, të cilat kanë ISSN të njëjtë.

---

### G.3.2 Formatit MARC

Shfaqja në formatin MARC mundëson paraqitjen e regjistrimit në formën e fushave dhe nënfushave të formatit COMARC/B (shih manualin *COMARC/B*).

Nga fusha e sistemit shfaqen këto të dhëna:

- numri identifikues i regjistrimit ("ID")
- numri lokal i regjistrimit ("LN")
- shenja e maskës
- shenja e variantit të regjistrimit
- data e krijimit të regjistrimit dhe emri i personit i cili e ka krijuar regjistrimin në bazën e të dhënave CORES
- data e ndryshimeve të fundit dhe emri i personit i cili ka ndryshuar regjistrimin në bazën e të dhënave CORES ("Updated")
- data e shkarkimit të fundit nga COBIB-i dhe emri i personit, i cili e ka shkarkuar regjistrimin ("Copied")